

VENDIM
Nr.520, datë 30.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.771, DATË 13.11.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 82 pika 1 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 4, 5 dhe 24 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 28 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të vendimit nr.771, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohen si më poshtë vijon:

“c. Institucionet buxhetore, duke filluar nga data 1 qershor 2005.

ç.Tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 janar 2005.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano